

FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE

E ENJTE 10 MARS 2022

E nderuar zonja Kryetare e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Fillimisht, më lejoni të filloj fjalën time sot duke përgëzuar në veçanti ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të gjithë kolegët e tjerë të angazhuar, si dhe kryetarin e komisionit, i cili është marrë veçanërisht me këtë ligj, për finalizimin e projektligjit “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”, për arsye të rëndësishme që ka ky projektligj në krijimin e një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për krijimin dhe zhvillimin e startup-eve dhe mbështetjen e ekosistemit të tyre, për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë, për zhvillimin ekonomik. Ky projektligj synon, gjithashtu, që përmes mbështetjes për zhvillimin e startup-eve të lehtësohet krijimi, hyrja në treg dhe ushtrimi i veprimtarisë së tyre, si dhe krijimi e nxitja e një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e talentit dhe burimeve njerëzore në vend.

Është koha kur të rinjtë me ide inovatore të bëjnë zgjedhje më të mira për karrierën e tyre dhe tregu shqiptar të orientohet drejt diversifikimit, duke ofruar produkte dhe shërbime më digjitale dhe inovative. Kthimi i vëmendjes te startup-et në një periudhë të vështirë, do të ndikojë pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit tonë, duke krijuar vende pune në ata sektorë të ekonomisë që janë orientuar drejt së ardhmes. Tre nga objektivat më kryesorë dhe ambiciozë që synohet të arrihen janë në përcaktimin e masave që mbështesin startup-et në fazën fillestare të biznesit dhe mbështetjen e ekosistemit për të krijuar një klimë të favorshme për to në vend; përcaktimin e organeve përgjegjëse, të cilat ngarkohen me detyrat e kompetencat për mbështetjen e startup-eve, si dhe përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave që zbatohen për certifikimin, mbështetjen, vlerësimin e monitorimin e startupeve. Projektligji ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe konkrete detyrat e caktuara për zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e mbështetjes së startup-eve.

Gjithashtu, ky projektligj parashikon ngritjen dhe funksionimin e këshillimit të startup-eve, i cili jep një kontribut në nxitjen dhe zhvillimin e tyre si organ kolegjial. Cila është filozofia që përpiqet të sjellë ky projektligj? Thjeshtësia në procedura dhe në përfitimin e masave mbështetëse. Prandaj projektligji parashikon që regjistrimi i një startup-i të bëhet përmes një vetëdeklarimi në regjistrin elektronik të startup-eve dhe lehtësuesve, duke u pajisur sipas rastit me dokumentin elektronik, që quhet “pasaporta e startup-eve” ose “pasaporta e lehtësuesve”. Një risi tjetër e këtij projektligji është ofrimi i shërbimit startup one-stop-shop, përmes të cilit do të mundësohet dhënia e informacionit për kuadrin ligjor rregullator në fuqi dhe dhënia e këshillimit lidhur me regjistrimin në regjistrin tregtar dhe mbrojtjen e të

drejtave civile dhe tregtare, si dhe për regjistrimin dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale, pas periudhës së inkubimit.

Përzgjedhja e startup-eve dhe lehtësuesve fitues, do të bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, për të shuar edhe dilemat e kolegëve opozitarë, të cilët i kishin parashtruar gjatë mbledhjeve të komisionit, siç është mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit; mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor; fuqizimi i grave sipërmarrëse; fuqizimi i përfshirjes sociale; diversiteti dhe impakti social; si dhe prioritete të tjera, të cilat do të bëhen nga komisioni i vlerësimit, ai që i propozon ministrit përgjegjës për Sipërmarrjen fituesit dhe ky i fundit më pas i propozon Këshillit të Ministrave projektvendimin për miratimin e granteve. Pse është e rëndësishme ndërmarrja e kësaj iniciative? Po t'i referohemi situatës aktuale në vend, duke marrë në konsideratë edhe rezultatet e raportit të vlerësimit të ndikimit, në Shqipëri nuk ka ende mekanizma nxitës apo kuadër ligjor, që rregullojnë specifikisht këto lloje biznesesh. Sektori i sipërmarrjeve të reja startup-e dhe programeve mbështetëse të tyre ka pasur probleme të rëndësishme në lidhje me hyrjen në treg dhe përthithjen e investimeve të huaja, pavarësisht interesit në rritje, kryesisht nga rinia shqiptare. Edhe pse legjislacioni ekzistues “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” rregullon disa çështje që lidhen indirekt me startup-et, ky kuadër ligjor nuk është i adresuar specifikisht te startup-et. Ky vakuum ligjor ka krijuar probleme lidhur me aksesin në financim, lidhur me marrjen hua nga institucionet bankare apo garanci të rreziqeve të lidhura me kreditimin nga qeveria.

Vështirësi tjetër përbën mungesa e informacionit mbi aspektet fiskale dhe ligjore, që lidhen me krijimin e sipërmarrjeve të reja, sidomos nga të rinjtë, si dhe mungesa e një kuadri ligjor që rregullon, nxit dhe përthith investimet e huaja dhe aktorët mbështetës në fushën e krijimit të sipërmarrjeve të reja, që sjellin risi dhe stimulojnë ekonominë. Sektori i startup-eve në Shqipëri ka pasur probleme për përthithjen e investimeve të huaja, pavarësisht interesit nga rinia shqiptare, dhe këto probleme reflektohen në aksesin dhe mbështetjen financiare të tyre. Eksperienca globale e tregjeve tregon një rritje të shoqërive sipërmarrëse të cilat sjellin modele, produkte apo shërbime të reja të biznesit, të cilat kanë potencial rritjeje në shkallë botërore, duke sjellë në kohë të shkurtër rritje ekonomike dhe punësim. Aktualisht, disa prej startup-eve janë shndërruar në shoqëritë tregtare nga më të mëdhatë në botë dhe shumë prej tyre kanë sjellë modele të reja komunikimi, tregtie dhe biznesi. Për sa u takon efekteve financiare që lidhen me zbatimin e këtij projektligji, është në masën 1 miliardë e 208 milionë lekë ose 10 milionë euro, dhe kjo shumë mendohet të bëhet e disbursueshme përgjatë 4-vjeçarit në vijim, ku përfshihen grante në formën e mbështetjeve financiare direkte për startup-et që plotësojnë kriteret, si dhe pagesa për 5 anëtarët e komisionit ad hoc që do të bëjnë përzgjedhjen e ideve fituese. Pavarësisht impaktit pozitiv që sjell miratimi i këtij projektligji, janë disa elemente të diskutueshme që diktuan nevojën për ndërhyrje dhe përmirësime nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Duke marrë parasysh edhe propozimet e grupit opozitar janë bërë saktësime në riformulimin e përkufizimeve, janë saktësuar dhe përcaktuar fushat e përgjegjësisë, funksionet dhe detyrat e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, kjo për vetë faktin se kompetencat apo strukturat e ministrit të Shtetit janë disi të kufizuara. Gjithashtu, është vlerësuar i nevojshëm saktësimi i monitorimit të masave mbështetëse dhe kufizimit në maksimum të skemave abuzive me grantet e përfituara. Për këtë qëllim është shtuar nga ne përcaktimi, se në rast të konstatimit të rasteve të abuzimit të masave mbështetëse

nga startup-et, lehtësuesit ose palët e treta, atëherë ministri përgjegjës për sipërmarrjen mund t'i propozojë Këshillit të Ministrave kthimin e shumës së përfituar sipas këtij ligji. Projektligji ka pasur nevojë, gjithashtu, për përmirësime të shumta të teknikës legislative, pasi krijonte vështirësi në aplikim dhe në zbatim. Besoj se të gjithë ne, kolegë, do ta votojmë këtë projektligj si një mundësi të artë jo vetëm për të rinjtë, por dhe për gratë dhe vajzat. Faleminderit!